



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 21.08.2023
02 Nr.400/01-21770/23

PROCESVERBAL

**Dëgjimi Buxhetor në Brezne, me banorët e fshatrave Brezne, Buqe,
Plavë, Rrenc**

I mbajtur më 21.08.2023, e hënë, duke filluar nga ora 18:00

VENDI: Shkolla e fshatit Brezne

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 14.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brezne.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brezne.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 17.08.2023:

Shqip: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=640486194847234&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=640486731513847&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
3. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 12 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 1
2. Meshkuj: 11

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komonale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjellësit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit. Me ardhjen në pushtet e kemi ritenderuar projektin e Ujësjellësit, pa ndryshime. Ky rrjet do të kushtojë afërsisht 2.5 milionë euro.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim prezanton para të pranishmëve Listën preliminare të shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2024.

Kërkesat e qytetarëve

Hajri Gashi, kryetar i fshatit Brezne:

- Rryma te lagjja e re është shumë e dobët. A mund të futet në buxhet ndonjë projekt për të intervenuar lidhur me këtë çështje?

Mehadin Gërdellaj, banor i fshatit Rrenc:

- Ne si fshat jemi pak të diskriminuar. Për vitin e ardhshëm për fshatin Rrenc janë ndarë vetëm 10 mijë euro. Nëse është mundësia pak me e rrit buxhetin, kur të bëhet rishikimi.

Remzi Misini, banor i fshatit Plavë:

- Për vitin 2024 kisha propozuar që klasat në shkollën e fshatit Plavë të shtrohen me linoleum, sepse pllakat lëshojnë shumë ftohtë. Gjithashtu, të intervenohet te rruga lidhëse me fshatin Buqe dhe të ndërtohet një trotuar përgjatë rrugës te Tyrbja.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim publik dhe fotografitë

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIM BUXHETOR

Vendi: BREZNE

Data: 21.08.2023

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënskrimi
1.	ELNIR KRASNIDI	BREZNE	
2.	PËRPARIM KRASNIDI	BREZNE	
3.	Xhemile Elshani Shala	Brezne	
4.	Flamur Kujezin	Brezne	
5.	MEHADIY ÇRDELLI	BREZNE	
6.	VIGAN BOJAXHIU	PLLAV	
7.	SHËRKAT LËKAJ	PLLAV	
8.	PERPARIM BOJAXHIU	PLLAV	
9.	MUHAMER LËKAJ	PLLAV	
10.	PJENTIN PIRAS	PLLAV	
11.	GEMZI MISINI	PLLAV	
12.	Hopë GASHI	BREZNE	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/21-21770/23
 21.08. 20 23
Dragash - Dragaš

